

VENDIM
Nr.102, datë 30.9.2011

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE ME SERI PM09SH, NR.77, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.23, DATË 25.3.2009 PËR SHOQËRINË KESH SHA**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.2, 2.3 dhe 2.5 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe neneve 10, 15 pika 2 germa “c”, pika 4 germat “a” dhe “b”, 17 pika 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009, të Bordit të Komisionerëve, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.9.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “KESH” sh.a. për ndryshimin e licencës nr.77, seria PM09SH, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.23, datë 25.3.2009 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit siç kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "KESH" sh.a., plotëson kërkesat ligjore, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës.

- Neni 15, pika 4, germa “b”: vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës me nr.77, seria PM09SH, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.23, datë 25.3.2009 për shoqërinë “KESH” sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani